



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Tiranë, më 16 Nëntor 2023

DEKLARATË PËR SHTYP

Të ndalet gjuha e urrejtjes në media dhe ajo denigruese me elementë presioni ndaj organeve të drejtësisë

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) në përmbushje të misionit të tij për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të shtetasve, ndjek, verifikon dhe monitoron zbatimin e tyre, në përputhje me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), Kushtetutën, legjislacionin vendas si dhe dokumentet e tjera ndërkombëtare ku kemi aderuar apo që përbëjnë praktika të mira orientuese për vendet demokratike.

Sipas dokumenteve të mësipërme, fjala e lirë dhe liria e medias cilësohen si një nga të drejtat themelore të domosdoshme në një shoqëri demokratike.

Zbatimit në praktikë të kësaj të drejte, KShH i ka kushtuar vazhdimisht vëmendje të veçantë, sepse siç dihet ushtrimi i saj është mjet i fuqishëm në konsolidimin e shtetit të së drejtës dhe sensibilizimit të opinionit të gjerë publik. Prandaj edhe thuhet se funksioni i medias së lirë është të marrë informacion dhe t'ja transmetojë atë publikut.

Edhe pse çështjet e mësipërme janë të qarta, KShH, me keqardhje konstaton se ka individë, përfshi këtu edhe ndonjë gazetar që në tejkallim dhe cenim të kësaj lirie, në fjalorin e tyre dhe në mungesë të etikës, përdorin gjuhën e urrejtjes në vend të argumenteve, komenteve apo analizave që do t'i shërbenin sqarimit të çështjes objekt debati, sidomos për publikun e gjerë që është i interesuar dhe ka aq shumë nevojë. KSHH sjell në vëmendje të Autoritetit të Medias Audiovizive, nevojën për të mbikëqyrur efektivisht zbatimin e Kodit të ri për Transmetimet Televizive që ndalon dhe sanksionon diskriminimin, dhunën me bazë gjinore dhe gjuhën e urrejtjes.

KShH vlerëson të domosdoshme në një shoqëri demokratike kritikën ndaj Qeverisë dhe funksionarëve publikë. Por cënimi i dinjitetit të njeriut, urrejtja që nxit dhunën, cënimi i parimeve kushtetuese të privatësisë dhe prezumimit të pafajësisë, janë të papajtueshme me lirinë e fjalës dhe të medias.

Nuk është tabu që kur është rasti të kritikohen edhe organet e drejtësisë të të gjitha niveleve, por s'ka asgjë të përbashkët me lirinë e fjalës dhe të medias, fyerja, denigrimi apo presioni ndaj tyre, e ndërlidhur kjo edhe me çështjet që janë në hetim apo për të cilat ka nisur një procedim penal.

Në përfundim e shikojmë të nevojshme t'i referohemi paragrafit të dytë të nenit 10 të KEDNJ, ku bëhet fjalë për kufizimet e ushtrimit të lirisë së shprehjes. Në këtë paragraf midis kufizimeve të tjera përmendet: sigurimi publik për mbrojtjen e rendit, parandalimi i krimit, mbrojtja e dinjitetit dhe të drejtave të të tjerëve, garantimi i autoritetit dhe paanshmëria e pushtetit gjyqësor.